Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Sahit Beqiri	**27.03.2024**	**06.04.2024**	**2024/0256**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **23.03.2024**, OE: **"GRANITI SH.P.K."- Suharekë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0256**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE: **Wood Corporation L.L.C.; Madekos Sh.p.k. - Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me mobilje"** me nr. të prokurimit: **"UA/2016-23-14297-1-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **– Agjencia Qendrore e Prokruimit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **Lot 1: 185,000.00€; Lot 2: 530,000.00 €**. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë **NUK** është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankese)

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 PërProkurim Publik

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Me dt. 06.03.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku për Lot 1 është rekomanduar për kontratë grupi i OE Wood Corporation L.L.C&Madekos SHPK, me vlerë prej 148,812.50 euro, ndërsa për Lot 2 është rekomanduar për kontratë grupi i OE PRIME CORPORATION L.L.C. & Erzeni SHPK ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm për Lot 1 dhe 2. neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar, me arsyetimin si në vijim:

Nuk e keni plotësuar kërkesën 2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – "Katalogu" meqë keni dorëzuar katalog ku ceket "devijimin e lejuar në dimension +/- 5 %". Me këtë rast nuk konsiderohet si katalog i rregullt ai katalog i cili përmban devijime në dimensione. Lejimi prej +/-5% tek Aneksi 1 i dosjes së tenderit është për kohen e ofertimit, pra secili OE ka pasur mundësi të ofertoj me produkte të cilat kanë mundur të kenë një devijimi prej +/-5% nga dimensionet e paraqitura në Aneksin 1, por përfshirja e këtij devijimi në katalog nuk ka kuptim dhe konsiderohet si variant gjatë realizimit të kontratës, andaj bazuar në pikën 4.1 të FDT-së Variantet nuk lejohen dhe me këtë rast oferta juaj për Lot 3 është vlerësuar e papërgjegjshme.

Ne akohemi per Llot-1 dhe Llot-2 dhe eshte per tu habitur fakti se si A.K na ka eliminu neve per variante +-5% ku në asnje menyre nuk i kemi ceke keto variane, ju lutemi ju si bord i OSHP-se shikoni dhe e vlersoni oferten tonë dhe me te vertet do te bindeni qe A.K nga pakujdesia apo me dashje na ka eliminu arsye qe nuk qendrojne qe per kete do te kerkojme drejtesi ne organet kompetente.

Ne kemi pasur qasje në dokumentet e operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë për lotet përkatëse dhe kemi vërejtur se këta OE kanë shume mangësi në ofertat e tyre të cilat i bëjnë të papërgjegjshëm këta operator ekonomik.

OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1 "Wood Corporation L.L.C & Madekos Shpk" është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

1. Anëtari i konsorciumit Madekos shpk merret me barna mjekësore dhe në **veprimtaritë e shënuara në ARBK nuk ka asnjë aktivitet të listuar për inventarit.** Pra fushë veprimtaria e këtij Bizensi është komplet jashtë natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit.
2. Të gjitha kontratat dhe referencat e prezantuara nga Madekos shpk janë për pajisje mjekësore të cilat nuk hyn në kategorinë e inventarit-mobileve, prandaj nuk duhet të merren parasysh dhe nuk janë të vlefshme këto kontrata apo referenca.
3. Ne nje reference e keti O.E Madekos eshte me shtreter spitali e qe jane shtreter mjekesor qe perdoren ne spitale qe fare nuk ka te beje me kete aktivitet. A.K duhet ta dije se tenderin e ka shpalle per inventar zyre e jo paisje mjeksore.

Në nenin 9.1&9.2 të FDT-së është kërkuar si në vijim:
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës se ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara, jo me pak se Lot 1 200,000.00 Euro Lot 2 700,000.00 Euro Lot 3 3,000,000.00 Euro.

Kurse dëshmia e kërkuar dokumentare është si në vijim:

Dëshmia 1 Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit apo ndonjë format tjetër që përfshinë afërsisht te dhënat e aneksit 8 dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë, gjithashtu Operatori Ekonomik për plotësimin e kësaj kërkesë mund te bashkëngjisë edhe Listë Libër të faturave të shitjeve (ku duhet të shihet qartë të paktën blerësi, data, artikujt dhe shuma duke ua bashkangjitur faturat si dëshmi) apo edhe duke paraqitur referenca si nga blerësi publik apo edhe nga blerësi privat.
Pra kontratat dhe referencat e prezantuara nga anëtari i konsorciumit Madekos shpk janë te paligjshme dhe në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Tek anëtari i grupit të konsorciumit **Wood Corporation L.L,** lista e kontratave është në vlerë 405,799.00 euro dhe janë kontrata në proces dhe asnjë tyre nuk mund të merret si vlerë referente.

Tek prezantimi i CD deklaratave dhe deklaratat e tvsh ka mos përputhje në të gjitha rubrikat kur klikohet në të p.sh CD 2021 OE ka deklaruar shitje të bruto të rubrika 60-974.386.87 ndërsa kur klikohet në të del vlera 10.129.210.87 euro ne te gjitha rubrikat cd 2021 cd 2022 ndryshon vlera, prandaj dyshohen se janë te manipuluara pra falsifikuara pasi që në tvsh kur klikon del vlera zero – 0.

4. Katalogu i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është ndryshe dhe nuk përkon foto me përshkrimin Teknik, modelet e treguara në foto janë jashtë çdo specifike dhe çdo standardi që është kërkuar në dosje të tenderit.

Pika 9.1&9.2 e FDT-së është shumë e qartë, ku shënohet Dëshmia 2. Katalogu për produktet qe oferton - Katalogu duhet të jetë i saktë për produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsione si minimum apo duhet të ketë... , pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog por duhet të ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni".

5. **OE ka dozuar 2 lloje të katalogëve** për artikuj të njëjtë. Është kërkuar në formën elipse ndërsa OE e ka prezantuar produktin ne formë drejtvizore, gjithashtu në fund të katalogut ka shenu: **Vërejtje (shënim me rendësi) se secilin artikuj mund ta prodhoj sipas kërkesë tuaj, e që është në kundërshtim me kërkesat e D.T.**
6. Në kërkesën e dosjes se tenderit ka qenë e cekur decidivisht për mos përdorim te anexit 1 të dosjes se tenderit, ndërsa **OE ka nënshkruar dhe vulosur Anexin 1** dhe e ka dorëzuar duke vepruar në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit, siç u cek më lartë.
7. OE i rekomanduar për kontratë **nuk ka dorëzuar dëshmi për afatin e liferimit,** prandaj është i papërgjegjshëm.
8. **OE nuk e ka dorëzuar deklaratën e specifikimit teknik për mallrat e ofruar ashtu siç kërkohet ne piken 3.1 te FDT**
9. Personi me emrin Driton Gashi ka vendosur shume nënshkrime, po që i njëjti nuk ka dëshmi **se ka autorizim nga firma.**
10. Tek shumica e kontratave dhe referencave dhe faturave të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, inventar **shënon vetëm që fare nuk dihet se çfarë inventari** është, pasi që në dosje të tenderit është kërkuar të shënohen artikujt dhe shuma si dhe totali.

Kontrata me Komunën e Deçanit me Nr. Prok. 631-23-3039-111, kur është dozuar Fatura me Nr.95/2023 date 26.09.2023 shihet shume qartë se OE i rekomanduar për kontrate ka bërë zhvatje ne këtë Komune, sepse në Faturë shënon Përshkrimi i artikujve: Inventar, Njesia: SET, Sasia: 1, Çmimi pa TVSH 12,181,36 plus TVSH 2,181.36 TOTALI **50,000.00 euro** dhe me dt. 09.10.2023 i bëhet pagesa komplet 50,000.00 euro, që sipas një parallogaria të thjesht del që OE e ka mashtru Komunën e Deçanit dhe i ka zhvat 35,625.99 euro.

Shih faturën dhe fletëpagesën e OE. Kjo kontratë është e pavlefshme dhe shumë e dyshimtë pasi që ka mospërputhje të vlerave dhe shumave të përfunduara, prandaj kërkojmë që të verifikohet.

" WOOD CORPORATION"L.L.C

Fabrika e Mobileve

Fatura : 95/2023

Data : 26.09.2023

" WOOD CORPORATION"L.L.C — Komuna Dragaš

Zona Industriale- Suharekë

No	Pershkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	PA TVSH	TVSH	Total
				euro €		euro €
1	Investimi	SET	1.00	12,330.04	2,169.96	50,000.00
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
					Total	50,000.00

Nënshkrimi i Shitësit

Emërtimi i Blerësit

Detajet bankare :
Emri i Bankës : TEB BANK
IBAN 20 25 00 01 67 07 65 05 Suhareka, Kosovë
Mbajtësi(Perfituesi) WOOD CORPORATION L.L.C

Ju falenderojmë per bashkëpunimin tuaj !
TE NASIRI
Adresa: Suhareka, Rr.Zeka Gajraktari (Kosovë)
Tel.+377 (0) 44 167 015 E-mail te: nasiri@outlook.com
www.FabrikaeMobileveTeNasiri.weebly.com

Shih faturën dhe fletëpagesën e OE. Kjo kontratë është e pavlefshme dhe shumë e dyshimtë pasi që ka mospërputhje të vlerave dhe shumave të përfunduara, prandaj kërkojmë që të verifikohet.

OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 Prime Coorporation është i papërgjegjshëm për tri Lotet me arsyet si në vijim:

1.Tek prezantimi i **CD deklaratave dhe deklarata TVSH ka mospërputhje** në të gjitha rubrikat Prime kur klikon mbi to tek viti 2022 ndryshojnë shumë shifrat, prandaj dyshojmë që të njëjtat janë të manipuluara.

2.Anëtari i grupi të konsorciumit Prime i posedon **dy referenca ku vlera e referencave është shumë më e madhe se sa vlera totale e qarkullimit të deklaruar në ATK**, andaj në këtë rast ka mospërputhje ndërmjet dy dokumenteve dhe dyshojmë që në këtë rast i njëjti OE ka bërë manipulime. Edhe pse në kalkulim i kemi përfshirë komplet vitin 2021, 2022, 2023 të shitjeve totale të deklaruara nga i njëjti, përsëri vlera e referencave e tejkalon qarkullimin e paraqitur me CD dhe deklaratat e TVSH.
Referenca e parë e OE të lartcekur prezantojnë shitje nga data 01.11.2021 deri me 30.06.2023 dhe referenca tjetër nga 27.07.2023 - 27.12.2023

3.Ne specifikimin teknik të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë **është përdorur minimumi dhe maksimumi** i produkteve me të cilat ka ofertuar.

Të gjitha karrigat në specifikimin teknik të OE të rekomanduar për kontratë, nuk e kanë vlerën e saktë të densitetit, mirëpo të gjithave **ju figuron (prej deri)**, gjë që është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit.
Gjithashtu poz. 5, poz. 6 sa i përket përmbajtjes se kromit e kanë prej 6 deri ne 12 mikrona, gjithashtu edhe katalogu-fotografitë e prezantuara janë të bërë kopje nga specifikimet teknike, ndërsa ky veprim është i ndaluar me kërkesën e dosjes së tenderit.

4.**Grupi i OE të rekomanduar për kontratë, janë të papërgjegjshëm për faktin se nuk e kanë prezantuar as deklaratën për specifikime teknike për mallrat e ofruara ashtu siç është specifikuar tek neni 3.1 i dosjes së tenderit.**

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se grupi i OE të lartcekur të rekomanduar për kontratë për Lot 2 janë të papërgjegjshëm dhe si të tillë është dashur të konsiderohen edhe nga ana e autoritetit kontraktues dhe jo të rekomandohen për kontratë.

OE Europrinty dhe **OE Mobelland** janë shpallur të papërgjegjshëm në tërë aktivitetin e prokurimit, prandaj qëndrojnë në tërësi arsyet e dhëna për këto kompani.

Për O.E Mobelland perveq disa kritereve qe eshte komplet i pa pergjegjshem shihet qart qe ka ofru nje katalog te pergjithshem qe eventualisht nese e fiton atehere me lehet te beje manipulime sepse nuk ka qartesi si dhe çmime manipulative, gjithashtu eshte ne konzercium me kompani te ndertimit qe fare nuk ka te beje me kete aktivitet te prokurimit.

Ne kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt14.03.2024, mirëpo që nuk është dhënë ndonjë arsye konkrete për këtë refuzim.

Në lidhje me pretendimet tona për OE të rekomanduar për kontratë për Lot 1 dhe Lot 2, autoriteti kontraktues nuk ka dëshmuar në asnjë mënyrë se këta OE i plotësojnë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, por vetëm ka qëndruar në tërësi pranë vlerësimeve të bëra dhe pranë njoftimit mbi vendimin e AK-së. Pra AK-së nuk ka mundur të argumentojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se ne si OE i përgjegjshëm jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit për dy Lotet, pasi që nuk jemi rekomanduar për kontratë, ndërsa janë favorizuar OE të lartcekur të cilët edhe pse janë të papërgjegjshëm, janë rekomanduar për kontratë, përkatësisht janë shpallur të suksesshëm.
Ofertat e OE të rekomanduar për kontratë nuk janë në harmoni me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj është dashur të eliminohen nga konkurrenca.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", mirëpo autoriteti kontraktues nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse ka rekomanduar për kontratë **operator ekonomik të papërgjegjshëm**.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP, që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **GRANITI SH.P.K & Trendy Home".**
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës për **Lot 1 dhe 2** dhe lënda kthehet në
RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), nuk janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues (sepse ne ankesën ne OSHP ka larguar nenin 6,56 dhe 72 te LPP-se),kurse tek Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – nuk janë te njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, pasi që(OE ankues ne ankesën pran OSHP ka plotësuar dhe shtuar disa pretendime/plotësuar), andaj duke marr për baze nenin 109 të LPP-së si dhe nenit 64.2 te Rreg. Nr. 001/2022 për PP, si neni 13 par. 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2020, do te mundohem te jap përgjigje vetëm ne pretendimet ankimore duke ju referuar KpR.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: **Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

Kërkesa 1 Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;	**Dëshmia 1 Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatoritekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);**

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar **Dëshmia e kërkuar dokumentar.**

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të shkuara një xhiro totale në EURO minimum Lit 1 350,000.00 Euro Lot 2 1,000,000.00 Euro Lot 3 4,000,00.00 Euro	**dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e shkuara ose vërtetim të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK-ja mbi qarkullimin financiar në tri vitet e shkuara ose gjendje e përgjithshme të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK.**

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional **Dëshmia e kërkuar dokumenta**

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës se ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara,	**Dëshmia 1 Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit apo ndonjë**

jo me pak se Lot 1 200,000.00 Euro Lot 2 700,000.00 Euro Lot 3 3,000,000.00 Euro	**format tjetër që përfshinë afërsisht te dhënat e aneksit 8 dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë, gjithashtu Operatori Ekonomik për plotësimin e kësaj kërkesë mund te bashkëngjisë edhe Listë Libër të faturave të shitjeve (ku duhet të shihet qartë të paktën blerësi, data, artikujt dhe shuma duke ua bashkangjitur faturat si dëshmi) apo edhe duke paraqitur referenca si nga blerësi publik apo edhe nga blerësi privat.**
Kërkesa 2 Katalogu për produktet qe oferton	**Dëshmia 2 Katalogu për produktet qe oferton - Katalogu duhet të jetë i sakët për produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsionie si minimum apo duhet të ketë... , pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog por duhet të ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni.**

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Garancioni për secilin artikull është 12 muaj nga pranimi i mallit.

Devijimi i lejuar në dimension është +- 5 % si për tavolina, dollapë dhe karriga zyrtare. Inventari duhet të jetë komfor specifikimeve teknike të specifikuara më poshtë dhe komfor standardeve.

Fotot janë vetëm për ilustrim, obligative është të plotësohet kërkesat e paraqitura tek "përshkrimi"

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Grup i Operatorëve Ekonomik GRANITI SH.P.K.; TRENDY HOME SH.P.K. ka plotësuar të gjitha kërkesat të parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë për **Lot 1 dhe Lot 2**, por meqë nuk qenë ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët, nuk është rekomanduar për kontratë.

Ndërsa për Lot 3 nuk e ka plotësuar kërkesën 2 të lartcekur – "Katalogu" të dosjes së tenderit meqë ka dorëzuar katalog ku ceket "devijimin e lejuar në dimension +- 5 %". Me këtë rast nuk konsiderohet si katalog i rregullt ai katalog i cili përmban devijime ne dimensione. Lejimi prej +/-5% tek Aneksi 1 i dosjes së tenderit është për kohen e ofertimit, pra secili OE ka pasur mundësi të ofertoj me produkte të cilat kanë mundur të kenë një devijimi prej +/-5% nga dimensionet e paraqitura në Aneksin 1, por përfshirja e këtij devijimi në katalog nuk ka kuptim dhe konsiderohet si variant gjatë realizimit të kontratës, andaj bazuar në pikën 4.1 të FDT-së Variantet nuk lejohen.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **GRANITI SH.P.K.**

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, ku OE ankues është eliminuar nga AK sa i përket "katalogut" meqë keni dorëzuar katalog ku cekëte "Devijimin e lejuar ne dimensione +/- 5%, ku konsiderohet si variante gjate realizimit te kontratës, andaj bazuar ne piken 4.1 te FDT-se, variantet nuk lejohen dhe me këtë rast oferta juaj për Lot 3 është vlerësuar e papërgjegjshme.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dosjen e tenderit, konkretisht Aneksin 1 specidikimi teknik i detyrushem, si dhe bazuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si në vijim:

Kërkesa 2 Katalogu për produktet qe oferton	Dëshmia 2 Katalogu për produktet qe oferton - Katalogu duhet të jetë produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsionie si minimum apo duh , pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog p

	ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni.

OE anketues ka dorëzuar, prezantuar "katalogun" te nënshkruar dhe te vulosur nga kompani, per lot 1 dhe per lot 2 OE ankues ka prezantuar ne pajtim te plote me kërkesën e dosjes se tenderit si me lartë, ndërsa për lot 3 duke vendosur tek përshkrimi i **"Për cdo dimesion lejohet +/- 5 %" qe do te thote se eshte ne kundershtim me kerkesen2/deshmin 2 te FDT-se, pasi qe paraqet opsion dhe kjo ka qene e ndaluar sipas kerkese me larte te dosjes se tenderit (sqarim: *Devijimi i lejuar +/-5 % nenkupton se OE me rastin e pergaditjes se katalugut ka mundur te paraqet ndryshime ne devijim ne secilin pozicion deri ne +/- 5%, por jo te vendos ne katalog per cdo dimesiona lejohet +/-5%, pasi qe kjo paraqet opsione dhe kjo ka qene e nduar me deshmin 2 te dosjese se tendeirt si me larte*), andaj** AK - Komisionit te vlerësimit ka vepruar ne pajtim me **nenit 59 par. 4 të LPP-së**, ku thotë: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit",* që do të thotë se arsyetimi ne raportin e vlerësimit, letrën standard te eliminimit dhe refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, lidhur me kete pikë janë ne pajtim dispozitaat ligjore te LPP-së, sepse vlerësimi i tenderëve nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave administrative dhe teknike të parashtruara në dosje te tenderit. Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nukjanë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, ku GOE te rekomanduar për dhënie te kontratës për **Lot 1** është i papërgjegjshëm për arsye si ne vijim:

1. Anëtari konsorciumit Medekos shpk merret me barna mjekësore dhe veprimtaria ARBE nuk ka asnjë aktivitet te inventarit.

Kontratat dhe referencat e prezantuar nga Madekos shpk janë pajisje mjekësore dhe nuk hyn ne kategorinë e inventarit-mobileve dhe janë ne kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit.

3. Lista e kontratave e anëtarit te grupit Wood është ne vlere 405,799.00 dhe janë kontrata ne proces nuk mund te merren si referente.

4. CD deklarimet dhe deklaratat e TVSH ka mos përputhje ne te gjitha rubrikat kur klikohet ne te psh. CD 2021 OE ka deklaruar shitje te bruto te rubrika 60-974.386.87 ndërsa kur klikohet ne te del vlera 10.129.210.87 euro ne te gjitha rubrikat cd 2021 dhe cd 2022 ndryshon vlera zero.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate, OE ankues nuk ka specifikuar saktë duke ofruar prova dhe argumente konkret, por vetëm ka përshkruar duke supozuar, p.sh.

1. Anëtari i konsurciumi Medikos, nëse referohemi kërkesës se dosjes se tenderit është kërkuar vetëm NUI por jo edhe kodet apo fushe veprimtari e biznesit!.

2. OE ankues nuk i ka cekur cilat kontrata konkretisht pasi aty janë disa andaj ESH e ka te pa mundur

te di çka ka menduar OE ankues dhe për cilat kontrata e ka pas fjalën?!.

3. Lista e kontratave tek OE WOOD Corporation sipas nr. rendor janë 42 dhe vlera total sipas listës është: 1,460,860.47€, andaj ESH e ka te pa mundur te di çka ka menduar OE ankues pasi qe nuk ke cekur saktë/konkretisht cilat janë ato kontrata qe janë ne proces dhe nuk mund te merren si vlerë referente duke saktësuar se cilat kontrata nuk pranohen?!.

Po ashtu, OE ankues ka ngritur pretendim për CD por pa specifikuar për cilin anëtarë dhe çka nuk plotësojnë këto CD, gjithashtu për manipulime dhe falsifikim OE ankues mund ti drejtohet organeve kompetente, pasi qe ESH nuk është kompetent te trajtoj këto çështje!.

Prandaj, pavarësisht këtyre sqarimeve si me larte, edhe pse OE ankues nuk ka specifikuar dhe ofruar fakte dhe argumente ESH edhe pas analizimit dhe hulumtimit te dokumenteve te prezantuar nga GOE te rekomanduar për kontratë, nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi qe bie ndesh me kriteret e përzgjedhjes te përcaktuar ne dosje tenderit, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, ku GOE te rekomanduar për dhënie te kontratës për **Lot 1** është i papërgjegjshëm për arsye si ne vijim:

1. Katalogu i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontrate është ndryshe dhe nuk përkon me foto me përshkrim teknik modelet e treguar ne foto janë jashtë çdo specifike dhe çdo standardi qe është kërkuar ne dosje tenderit.

2. Ka dorëzuar dy lloje te katalogëve për artikuj te njëjtë. Është kërkuar ne forme elipse ndërsa OE e ka prezantuar produktin ne forme drejtvizore, gjithashtu ne fund te katalogut ka shënua: Vërejtje (shendim me rendësi) ne secilin artikuj mund ta prodhoj sipas kërkesës tuaj , e qe është ne kundërshtim me kërkesat e D.T.

3. OE ka nënshkruar dhe vulosur Aneksin 1

4. OE nuk ka dorëzuar dëshmi për afatin e liferimit

5. OE nuk ka dorëzuar deklaratën e specifikimit teknik për mallrat e ofruara ashtu siç kërkohet ne piken 3.1 te FDT-se.

6. Personi i me emrin Driton Gashi ka vendosur shume nënshkrime, por nuk ka autorizim nga firma.

7. Tek shumica e kontratave dhe referencave dhe faturave OE i rekomanduar për kontrate inventar shënon vetëm qe fare nuk dihet se çfarë inventari është?.

8. Kontrata me Komunën e Deçanit me Nr. 631-23-3039-111, ka mashtruar Komunën e Decanit dhe i ka zhvat 35,625.99 euro, ka mos përputhje te vlerave.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se

prokurimit, bazuar ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate, OE ankues nuk ka specifikuar saktë duke ofruar prova dhe argumente konkret, por vetëm ka përshkruar duke supozuar, p.sh.

1. GOE te rekomanduar për kontrate për Lot 1 ka tenderuar për Lot 1 dhe për Lot 3 si dhe ka prezantuar katalogët për secilin Lot, andaj pretendimi i OE ankues modelet e treguar ne foto, përveç fotove është edhe përshkrim teknik i cili është ne përputhje me aneksin 1 te dosjes se tenderit, andaj fotot janë sa për ilustrim, po ashtu OE ankues nuk ka specifikuar konkretisht cili artikull është jashtë specifikave dhe cilat foto nuk përputhet me përshkrimin ne katalog.

2. GOE te rekomanduar për kontrate për Lot 1 ka tenderuar për Lot 1 dhe për Lot 3 si dhe ka prezantuar katalogët për secilin Lot, andaj pretendimi i OE ankues nuk është sqaruar se për cilin katalog dhe cilin artikull andaj është e pa qarte "është kërkuar ne forme elipse" ndërsa ka prezantuar produktin ne "forme drejtvizore" qe te do te thotë nuk ka specifikuar cilin katalog, cilin artikull pasi qe ESH e ka te pa mundur te di se për cilin artikull dhe cka ka menduar OE ankues.

3. Nënshkrimi dhe vulosja e Aneksit 1 te FDT-së, plotëson kërkesën 3.1 te FDT-së, është ekuivalente me deklaratën për specifikim teknik.

4. Afati i liferimit është kushte administrativ – është obligim për çdo tenderues, sepse nuk është kërkuar tek kriteret e përzgjedhjes (nuk është kusht i vlerësimit, por është kushte i implementimit te kontratës) nuk hyn ne vlerësim si dhe është specifikuar tek neni 19.3 KVK i cili ka te beje me implementimin e kontratës.

5. OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar aneksin 1 te FDT-se te nënshkruar dhe te vulosur andaj e plotëson kërkesën 3.1 te FDT-se është ekuivalente si te dorëzohet deklarata apo/ose te nënshkruhet dhe vuloset aneksi 1 i FDT-së.

6. Driton Gashi, bazuar ne NUI te OE është përfaqësues ligjor dhe dokumentet e nënshkruar janë nga personat kompetent.

7. Tek shumica e kontratave, pas specifikuar sakte, konkretisht, cila kontrate dhe cila është vlera e atyre kontratave qe shënon inventar, por edhe përkundër kësaj bazuar ne kërkesën 1 dhe dëshminë 1 te FDT-se, OE i rekomanduar për kontrate e plotëson këtë kërkesë.

8. Sa i përket pretendimeve për manipulime dhe falsifikim OE ankues mund ti drejtohet organeve kompetente, pasi qe ESH nuk është kompetent te trajtoj këto çështje!.

Prandaj, pavarësisht këtyre sqarimeve si me larte, edhe pse OE ankues nuk ka specifikuar dhe ofruar fakte dhe argumente ESH edhe pas analizimit dhe hulumtimit te dokumenteve te prezantuar nga GOE te rekomanduar për kontrate, nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi qe bie ndesh me kriteret e përzgjedhjes te përcaktuar ne dosje tenderit, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, ku GOE te rekomanduar për dhënie te kontratës për **Lot 2** është i papërgjegjshëm për arsye si ne vijim:

1. Prezantimi i CD deklaratave dhe deklaratave te TVSH ka mos përputhje tek viti 2022 ndryshojnë shifrat, prandaj dyshojmë qe te njëjtat janë te manipuluara.

2. Anëtari i grupit PRIME i posedon dy referenca ku vlera e referencave është shume me madhe se sa vlera e qarkullimit te deklaruar ne ATK , ku dyshojmë se ka bere manipulime.

3. Ne specifikime teknike GOE te rekomanduar për dhënie te kontratës është përdorur min. dhe max. i produkteve me te cilat ka ofertuar; nuk e kanë vlerën e densitetit ju figuron prej deri, gjë qe është ne kundërshtim me dosjen e tenderit; gjithashtu, poz. 5 dhe poz. 6 s i përket përmbajtjes se kromit e kane prej 6 deri 12 mikron edhe fotografit e prezantuara janë te bërë kopje nga specifikimet teknike, ky veprim është i ndaluar me kërkesën e dosjes se tenderit.

4. GOE i rekomanduar për kontrate ju mungon deklarata mbi specifikimin teknik siç është specifikuar tek neni 3.1 i dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate, OE ankues nuk ka specifikuar saktë duke ofruar prova dhe argumente konkret, por vetëm ka përshkruar duke supozuar, për pika si në vijim:

1. Sa i përket pikës 1 pretendimeve për manipulime dhe falsifikim OE ankues mund ti drejtohet organeve kompetente, pasi qe ESH nuk është kompetent te trajtoj këto çështje!.

2. Sa i përket pikës 2 pretendimeve për manipulime dhe falsifikim OE ankues mund ti drejtohet organeve kompetente, pasi qe ESH nuk është kompetent te trajtoj këto çështje!.

3. Përshkrimi teknik ne katalog te ofruar nga GOE është ne pajtim te plote me specifikimin teknik me aneksin 1 te FDT-se; sa i përkëte densiteti edhe ky është ne përputhje me dosjen e tenderit (pasi qe OE ankues ka specifikuar pse është ne kundërshtim me dosjen e tenderit); sa i përket përmbajtjes se kromit është ne pajtim me përshkrimin ne aneksin q te FDT-se, kurse sa i përket fotografive se janë bere kopje për këto dy (2) pozicione nga specifikimi teknik ngjasojnë por nuk mund te nxjerrim një konstatim se janë identike, pasi qe edhe pozicionet tjera ngjasojnë, andaj është e vështirë ne cilësinë e ESH te konstatoj se janë kopjuar, pasi qe mund edhe te mos jete kopjuar por janë te ngjashme.

4. AK ka mundur te kërkoj deklaratë mbi specifikimin teknik tek kërkesat teknike dhe/ose profesionale si kritere te përzgjedhjes, apo ose/dhe ta kërkoj tek specifikimi teknik ne aneksin 1 të FDT-së, apo/ose tek Dokumentet qe përbejnë Tenderin **neni 19.1(h) të FDT-së**, prandaj AK – Komisioni i vlerësimit kanë mund te veproj sipas **nenit 59 par. 4 të LPP-së**, sepse OE ankues i ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes dhe për një deklaratë tek neni 3.1 i FDT-së te eliminohet OE ankues (ku zakonisht OE i kushtojnë vëmendje kritereve te përzgjedhjes dhe aneksit 1 të FDT-së), prandaj nuk ka arsyeshemëri logjike dhe ligjore te eliminohet GOE i rekomanduar për dhënie te kontratës pasi qe aneksi 1 te FDT-se e mbulon katalogu i cili është sipas dosje se tenderit.

Prandaj, pavarësisht këtyre sqarimeve si me larte, edhe pse OE ankues nuk ka specifikuar dhe

ofruar fakte dhe argumente ESH edhe pas analizimit dhe hulumtimit te dokumenteve te prezantuar nga GOE te rekomanduar për kontrate, nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi qe bie ndesh me kriteret e përzgjedhjes dhe aneksin 1 te FDT-se te përcaktuar ne dosje tenderit, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese për ***pikën 3 dhe 4janë pjesërishtë të qëndrushëme***, kurse **piken 1 dhe 2 nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, ku OE Europrinty dhe Mobelland, janë te papërgjegjshëm qëndrojmë ne tërësi arsyet e dhëna për këto kompani; për O.E. Mobeland shihet qarte se ka ofruar një katalog te përgjithshëm, nuk ka qartësi, gjithashtu është ne konsurcium me kompani te ndërtimit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, sa i perket OE: "Europrint" ky OE është palë pa interes sipas nenit 4.1.26 te LPP-se, pasi qe është pajtuar me B058 njoftimin mbi vendimin e AK, mirëpo bazuar ne letrën standarde te eliminimit për këtë AP arsyet e eliminimit janë te identik për te njëjtën çështje "devijimi +/- 5%" si për OE ankues po ashtu kam dhenë sqarim ne përgjuan ne pretendimin nr. 1. Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk janë të qëndrueshëm.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **ka respektuar nenin 7 dhe 59 të LPP-së**, si dhe andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe të gjeturat tjera në këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues
*të **aprovohet si pjesërisht të bazuara*** (*për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr. 4*), *dhe të njëjtin tender për **Lot 1dhe Lot 2***
*rekomandojmë që të **mbete në fuqi vendimi i AK** lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.*

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **GRANITI SH.P.K.**

Sahit Beqiri